

Ta bëjmë Steblevën më të bukur, më të gjelbëruar dhe më të begatë

STEBLEVA



GAZETË E SHOQATËS "STEBLEVA"

Nr.19. Qershor 2010.

Çmimi 50 lekë.

**NË KËTË NUMËR
DO TË LEXONI**

**Rruga Librazhd-
Steblevë, shpresa
e madhe e
banorëve të zonës**

(Punimet janë ndërprerë,
për shkak të vonesave në
lëvrimin e fondit)
FAQE 7

**Shënime ndër vite
për Steblevën**

Nga Ismail Lila
FAQE 2

**Të promovojmë
traditën e
mjeshtrave të
punës në Steblevë**

Nga Osman ULIU
FAQE 3

**Apel:
Të bëjmë kujdes për
varrezat e Steblevës**

FAQE 3

**Një jetë në shërbim
të fshatit**

(Intervistë me Jakup
Projkun para vdekjes,
më 6 maj 2005)
FAQE 4

**ALI PROJKU, NJERIU
PA DUAR, QË
PUNONTE MË SHUMË
SE TË TJERËT**

FAQE 4

Përse nuk po gjen zbatim vendimi i gjykatës për çështjen e burimeve të ujit tek "Kodra e Bukur"?



NJOFTIM

Me datë 20 qershor ora 11.00 tek fusha e piramidës 30 organizohet takimi përkujtimor kushtuar 95 vjetorit të rënies së patriotit steblevas Hasis Lila. Ftohen të marrin pjesë të gjithë banorët e Steblevës kudo që ndodhen.

KOMISIONI ORGANIZATOR

Nderohet emri i Vaid Kormakut

Në kuadrin e emërtimeve të rrugëve të kryeqytetit me emra dëshmorësh e figurash historike, një rrugë në lagjen Ali Demi (Kodra e Priftit) i jepet emri i mësuesit dhe patriotit nga Stebleva Vaid Kormaku.

FALENDERIM

Falenderojmë zotërinjtë Bardhyl Faik Kormaku, Shpëtim Idriz Kormaku dhe Rruzhdhi Abdurrahman Kormaku për sponsorizimin e numrit 19 të gazetës "Stebleva"

**NË KËTË NUMËR
DO TË LEXONI**

**Bill Clinton pritet
si hero në Prishtinë**
FAQE 8

**BIJTË KTHEHEN NË
VENDLINDJE**

(Nga festimi i 6 majit
në Steblevë)
FAQE 5

**"Dy martirët e
Steblevës", një libër
me vlera atdhetare
dhe një thirrje për
kujtesë kombëtare..**

Nga Mehmet HASANI
FAQE 6

**Homazh për të gjitha
gratë e vajzat luftëtare
shqiptare, dibrane dhe
të Steblevës**

Nga Ramazan HOXHA
FAQE 7

**ISLAM FERIT
ÇAUSHI, DËSHMOR
I LUFTËS NACIONAL
ÇLIRIMTARE
(1922-1945)**

Nga Rruzhdhi KORMAKU
FAQE 7



ANGELS TRAVEL & TOURS

Mersin Hoxha
Administrator

Bileta avioni, Trageti, Turizëm, Akomodim

Adresa: Rruga e Barrikadave, P. 218, Kati përdhe
(Ngjitur me Lëvizjen "Mjafi", Afër Stacionit të Trenit)
Tirana - Albania

Tel/Fax. +355 4 2222519. Cel. 069 20 65 091

E-mail: mersin_hoxha@yahoo.com
angels.tours@hotmail.de



DHOMA KOMBËTARE E AVOKATËVE, TIRANË



**MEHMET D. KURTI
AVOKAT**

Adresa:
Rr. "A.Z.Çajupi", P.20/4
Zyra e Avokatisë, Nr. 10/z
E-mail: kurti_m@hotmail.com

Tel/Fax: 042 254 177
Mob. 068 20 54 686
069 26 17 703

REDAKSIA E GAZETËS "STEBLEVA".

Drejtor: Mersin Hoxha/ Redaktorë: Halil Kurti, Asjap Gruda, Artan Lila, Reshat Gruda.
Kryeredaktor: Sakip Cami

Përse nuk po gjen zbatim vendimi i gjykatës së shkallës së parë të rrethit gjyqësor të Elbasanit për çështjen e burimeve të ujit tek "Kodra e Bukur"?

Më poshtë po japim edhe një herë tjetër vendimin e Gjykatës së Elbasanit.

**GJYKATA E SHKALLËS SË PARË
TË RRETHIT GJYQËSOR TË ELBASANIT PRANON KËRKESËN DHE I
JEP TË DREJTË STEBLEVËS PËR ÇËSHTJEN E BURIMEVE TË UJIT
TEK "KODRA E BUKUR".**

(Avokati Mehmet Kurti mbron me sukses çështjen)

Vendimi i Qarkut të Dibrës për dhënie leje ndërtimi për ujësjellësin e livadhit të lepurit veç mangësive që ka nuk konsiderohet i ligjshëm përderisa i shtrin efektet jashtë territorit që ka në administrim.

Gjykata, bazuar në nenet 202/a dhe 204 vijues K.Pr.Civile
Vendosi

Pranimin e kërkesës që i përket kërkuarit Rexhep Kurti për "sigurimin e padisë".

Pezullimin e punimeve të ndërtimit të ujësjellësit rajonal Raduç-Ostren të kryera në territorin e fshatit Steblevë.

U shpall në Elbasan me datë 23.11.2009

Sekretare Klarita Biçoku

Gjyqtar Taulant Tafa

Në numrin e kaluar të gazetës "STEBLEVA" jeni njohur me punën dhe përpjekjet e shoqatës "STEBLEVA" për mbrojtjen e burimeve të ujit, pyjeve, kullotave dhe pronave të komunitetit steblevas.

Meqenëse çështja e grabitjes së burimit të ujit tek Livadhi i lepurit tashmë po përbën një shqetësim të madh të mbarë komunitetit steblevas, u bë kallzimi penal në gjykatën e shkallës së parë të rrethit të Elbasanit.

Kryeplaku i fshatit Steblevë Rexhep Kurti paraqiti pranë Gjykatës së shkallës së parë të rrethit gjyqësor të Elbasanit kërkesën për "sigurimin e padisë" ngrihur kundër të paditurve zyra e urbanistikës KRRT Qarkut Dibrë, "Egland/B" sh.p.k dhe "Gjoka" sh.p.k, personit të tretë Komunës së Ostrenit të rrethit të Bulqizës, me objekt pushim cenimi dhe shpërbllim dëmi.

Gjatë shqyrtimit gjyqësor rezultoi se subjektet ndërtuese "Egland/B" sh.p.k dhe "Gjoka" sh.p.k janë duke ndërtuar punime për ndërtimin e ujësjellësit Ostren-Raduç, punime këto të kryera sipas vendimit Nr 3 datë 26.06.2009 të KRT të këshillit të qarkut të Dibrës ku është miratuar leja e sheshit të ndërtimit.

Nga provat paraprake të ndodhura në dosje rezulton se vendimi i lartpërmendur, konkretisht në lejen e ndërtimit nuk është përcaktuar subjekti ndërtues dhe licenca përkatëse duke shkelur në këtë mënyrë ligjin Nr 8405 datë 17.09.1998 "Për urbanistikën".

Po ashtu vetë Komuna Ostren e shkresën Nr 90 datë 27.08.2009 i ka kërkuar zyrtarisht Komunës Steblevë të konfirmojë dhe të miratojë marrjen e ujit të ujësjellësit që po ndërtohet nga burimi i quajtur me emërtimin popullor "Livadhi i lepurit" dhe kjo e fundit nuk ka miratuar këtë kërkesë, pasqyruar edhe në vërtetimin e Komunës Trebisht datë 29.09.2009.

Sipas dokumentave të vitit 1937, e rifreskuar në vitin 2001 janë përcaktuar kufijtë midis fshatrave Steblevë, Klenjë, Gjinovec, Trebisht dhe Borovë ku kryepleqtë e këtyre fshatrave kanë rënë dakord me përcaktimin e kufijve.

Pra në rastin konkret sipas dokumentit të lartpërmendur si dhe hartës përkatëse të fshatit Steblevë, miratuar kjo edhe nga Prefektura e Qarkut Elbasan me shkresën Nr 3877/1 prot datë 10/09/2007 rezulton se fshati Klenjë nuk ka kufitar fshatin Ostren dhe se vendi i quajtur me emërtimin popullor "Kodra e Bukur" përfshihet në territorin e fshatit Steblevë, që si njësi administrative, bazuar edhe në ndarjen territoriale administrative përfshihet si territor i Qarkut të Elbasanit, pra edhe vendimi i Qarkut të Dibrës për dhënie leje ndërtimi për ujësjellësin e lartpërmendur veç mangësive të cituara më lart nuk konsiderohet i ligjshëm përderisa i shtrin efektet jashtë territorit që ka në administrim.

Veç sa më lart në bazë të vendimit të Këshillit të Ministrave Nr 64 datë 21.05.2008 zona pyjore fshati Steblevë është shpallur "Park Kombëtar" e mbi këtë bazë Këshilli i Komunës Steblevë me vendimin Nr 62 datë 06.09.2007 ka vendosur të miratojë planin e menaxhimit të projektit të pyjeve dhe kullotave, e miratuar kjo nga Prefekti i Qarkut të Elbasanit sipas konfirmimit të aktit datë 10.09.2007 ku janë bashkëngjitur dhe harta territoriale e Komunës së Steblevës.

Para fakteve të tilla gjykata çmon se kërkesa e paraqitur nga kërkuari përmes plotësisht kriteret e përcaktuara në nenin 202/a të Kodit të Procedurës Civile, e si e tillë duhet pranuar.

Gjykata çon që dokumentat e disponuara në dosjen gjyqësore justifikojnë kërkesën e paraqitur nga kërkuari Rexhep Kurti, për "sigurimin e padisë".

Për këto arsye

Gjykata, bazuar në nenet 202/a dhe 204 vijues K.Pr.Civile
Vendosi

Pranimin e kërkesës që i përket kërkuarit Rexhep Kurti për "sigurimin e padisë".

Pezullimin e punimeve të ndërtimit të ujësjellësit rajonal Raduç-Ostren të kryera në territorin e fshatit Steblevë.

U shpall në Elbasan me datë 23.11.2009

Sekretare Klarita Biçoku

Gjyqtar Taulant Tafa

KOMUNA E STEBLEVËS I KËRKON INSPEKTORIATIT TË NDËRTIMIT TË QARKUT TË ELBASANIT PRISHJEN E PUNIMEVE TË DERITANISHME DHE MOSVAZHDIMIN E PUNIMEVE.

Këshilli i Komunës së Steblevës në mbledhjen e tij të datës 17.11.2009 pasi u njoh me procedurat e deritanishme në lidhje me ndërtimin pa leje në territorin e komunës sonë të ujësjellësit të Komunës së Ostrenit kërkon nga inspektoriati i ndërtimit të Qarkut të Elbasanit prishjen e menjëhershme të këtij objekti për të shmangur konfliktet sociale midis fshatrave dhe komunave.

Shënime ndër vite për Steblevën



Nga Ismail Lila

Stebleva është një fshat që aktualisht bën pjesë në rrethin e Librazhdit, qarku i Elbasanit. Para vitit 1990 bënte pjesë në rrethin dhe qarkun e Dibrës. Edhe nga traditat dhe nga etnografia anon me shumë nga Dibra, dhe steblevasit mburren se janë nga Stebleva e Dibrës. Me Dibrën e Madhe kanë vetëm 3 km largësi në vijë ajrore. Stebleva shtrihet në një lartësi rreth 1200 m mbi nivelin e detit. Ka klimë shumë të mirë me ajër të pastër dhe me ujë të kulluar, që del nga burime të shumta natyrore. Pyjet dhe livadhet shumëgjyreshë mbulojnë territorin e Steblevës që kufizohet me shumë fshatra të tjerë brenda dhe jashtë kufirit. Nga Guri i Shqipes deri tek Varri i Nuses zotëron një kufi shtetëror prej 30 kilometrash me Maqedoninë. Në mesin e kësaj vije në Piramidën 30 është planifikuar të ngrihet pika kufitare doganore me Maqedoninë. Me Borovën kufizohet deri tek Ara e Lilës dhe me Mirakën deri tek Varri i Ogiçit. Ka një hapësirë territorial shumë të madhe si rrallë në ndonjë fshat tjetër.

Fshati fillimisht ishte në Orvenike ose Uraniku që përmendet në histori si bazë e luftës për ushtrinë e Skënderbeut. Fshati ka qenë shumë i vjetër dhe nuk dihet së kur është krijuar. Fshati ishte në pozicion shumë të mirë, por kishte një burim uji. Gradualisht njerëzit filluan të largohen në një vend tjetër jo shumë larg, por që kishte ujë të bollshëm si për njerëzit ashtu edhe për bagëtitë. Fshati ka pasur tradita të shumta dhe njerëzit kanë pasur virtyte të larta. Steblevasit kanë pasur shumë unitet midis tyre, ndaj kanë arritur të mos

lejojnë cenimin e tokave të shumta, që nga sipërfaqja ia kalojnë të gjitha fshatrave të tjera përreth.

Për mbrojtjen e tropeve tona, toka, livadhe, pyje dhe kullota ka luajtur një rol të jashtëzakonshëm kryeplaku Adem Bojaxhiu, i cili për 30 vjet me rradhë së bashku me bashkëfashatarët e tij e mbrojtën edhe me gjak. Në vitin 1937 u bë e mundur që të regjistrohet tapia e fshatit tonë, tapi që e kemi edhe sot. Por egziston edhe një tapi tjetër ajo e kohës së Turqisë, për të cilën kemi ba disa gjyqe deri në Stamboll.

Tre herë është djegur Stebleva dhe tre herë e kemi rindërtuar atë. Më 1913, 1915, 1920. Në vitin 1920 në Steblevë është ba luftë e përgjakëshme dhe ka hyrë në histori si lufta e Steblevës. Patriotë dhe luftëtarë të shquar si Hoxhë Lila, Ajdin Gruja, Islam Lama, Adem Bojaxhiu etj kanë luftuar për gjuhën shqipe, për liri dhe pavarësi deri në vetmohimin e jetës së tyre. Mësues të tillë si Vahid Kormaku, Islam Hoxha etj kanë mjellur jo vetëm farën e arsimit në Steblevë, por edhe në mbarë Dibrën deri në Gramsh.

Të bashkuar kundër hasmit që ka dashtë me marrë dhe shkelë trojet tona, jemi bashkuar, jemi forcuar dhe jemi kalitur duke u bërë fshati pa vëllavrasje, pa grindje, pa vjedhje në çdo kohë. Bashkëjetësa dhe harmonia fetare midis myslimanëve dhe ortodoksëve na ka karakterizuar në çdo kohë. Të bashkuar jemi edhe sot. Megjithëse të shpërndarë kudo anë e mbanë vendit, në Elbasan, Tiranë, Durrës, Peshkopi, Bulqizë etj, në SHBA, Turqi, Maqedoni etj, steblevasit mbledhen me një thirrje kur bëhet fjalë për të mbrojtur fshatin, trojet dhe traditat e tyre.

Refleksione

Të promovojmë traditën e mjeshtreve të punës në Steblevë

Nga Osman ULIU

Historikisht përpunimi i produkteve të natyrës nga njeriu në shërbim të njeriut ka kaluar në faza të ndryshme. Në fillim ka egzistuar përpunim me dorë ose artisanal siç njihet, më pas ka vazhduar përpunim industrial. Sot që jetojmë në kohën e internetit dhe të industrializimit, kanë dalur në plan të parë prodhimet "bio". Të merr malli për prodhime fshati, për prodhime vendi, për prodhime natyre. Pëlqejmë rakinë e bërë vetë. Me shaka i themi BMV. Na merr malli për një gotë dhallë stebleve, për kosin e prerë me thikë, për të cilin ndalonin të gjithë udhëtarët dhe kalimtarët në Steblevë.

Sot ka shumë steblevas tregëtarë të sprovuar, ka ustallarë të mirë, etj, por ka nevojë që të promovohen më shumë vlerat tradicionale të ndërtimit, të ushqimit, të tregëtisë, të përpunimeve të ushqimeve të shtëpisë si pastërmaja, turshitë etj. Tani që Stebleva mund të promovohet edhe si

zonë turistike, duhet të ndërtojmë oxhaqet e buykur nëpër shghtëpitë tona dhe të gatujmë "bio" për turistët sepse ata për natyrën dhe prodhimet e saj vinë dhe jo për industrialen sepse atë e kanë në vendet e tyre.

Njihet historikisht deri në ditët tona terziu (rrobaqepësi) me emër Musa Kormaku (Terziu) që proste dhe qepte jo vetëm costume modern, por edhe costume popullore, xhamadanë e jelekë, xhoke grash etj. Tek Musai kërkonin të qepnin edhe të mëdhenjtë e pushteit të asaj kohe. Po kështu edhe Mustafa Lila ka qenë mjeshtër i madh në fushën e rrobaqepësisë

Si u krijua kënga "O usta Murat"

Kushdo e ka dëgjuar këngën "O usta Murat", sidomos në dasmat e Shqipërisë së Mesme. Por jo të gjithë e dinë se kjo këngë i kushtohet byrekbërësit më të famshëm të atyre viteve, Murat Lama nga Stebleva që punonte në Kavajë. Murati me punën e tij shumë shpejt u bë i famshëm si për cilësinë dhe për punën pa orar në



shërbim të njerëzve. Murati ka patur byrektore, punishte për përpunim qumështi dhe furnizonte të rë Kavajën.

Kënga thotë:

Te dyqani tek Selvia, O usta Murat

Në punë nana edhe e bija, o usta Murat

Byrek, byrek, o usta Murat,
Katër copa bëjnë tre lek, o usta Murat...

Dhe Murat Lama nuk ka qenë i vetmi tregëtar i njohur nga Stebleva sepse steblevasit e kanë zanat tregëtinë. Steblevasit kanë pasur dyqane kudo:

" Në Elbasan : Kormakajt, Gjinajt, Lamajt, Amdiajt, etj.

" Në Kavaje : Murat Lama nga Stebleva ka qenë më i miri për prodhimin e byreqeve .

" Në Tiranë : Kucukajt, Kurtajt, etj.

" Në Durrës : Dan Agushi, Ibrahim Avda, etj.

" Në Strugë si dhe në Oher, Shkup e ne disa qytete të tjera : më të dëgjuarit janë në Stamboll që janë edhe sot e kësaj ditë tregtare të mëdhenj.

Tani në Tiranë janë të dëgjuar shumë tregëtarë nga Stebleva. Numri i tyre është pambarim.

Ka patur shumë mjeshtër në të gjitha fushat, për të cilët duhet të shkruajmë dhe ti promovojmë edhe në të ardhmen.



Qëndresa popullore nëpërmjet folklorit

A pushoi shiu në Shkodër?

Në kohën e Turqisë, Porta e Lartë e Stambollit emëronte jo pa qëllim nëpunësa të lartë në Shqipëri pashallarët shqiptarë. Me një të shtënë zinte dy zogj. Mbante nën sundim popullin dhe e mbante me pashallarë vendas. Një prej tyre që u emërua në Shkodër ishte Abdurrahman Pasha. Abdurrahmani qëndroi jo pak, por 6 muaj. Dhe gjatë gjithë kohës në Shkodër ra shi dhe shiu nuk pushoi fare. Pas 6 muajsh Abdurrahmani u transferua në Stamboll. Atje takohet me një mikun e tij shqiptar, Muharrem Pashën. Muharremi e pyeti: "Po ku ke humbur bre mik? Kam qenë me shërbim në Arnautistan , në Shkodër.

Muharremi e pyeti menjëherë: "A binte shin ë Shkodër ?

Shi dhe çfarë shiu, nuk pushoi fare për 6 muaj sa ndejta unë , u përgjigj Abdurrahman Pasha. *

*Shiu nënkuptonte zemërimin popullor të qytetit të Shkodrës që nuk prante pushtimin turk.

Përgatiti: Ferit Pirushi

APEL

Të bëjmë kujdes për varrezat e Steblevës

Po ndiqja një emision në TCH për shtetin e Teksasit në SHBA. Më bëri përshtypje rindërtimi i një qyteti nga e para. Në vitin 1950 ishte mbyllur miniera e qymyrit dhe njerzit ishin larguar. Kishin shitur shtëpitë për 50 dollarë dhe ishin larguar nëpër qytete të tjera. Tani pas 50 vitesh një grup burrash të moshuar që në atë kohë ishin 20-30 vjeçarë ishin kujtuar për qytetin e tyre në zhdukje dhe kishin filluar punën për ringritjen e tij. Kishin ngritur disa shtëpi prej druri njëlloj si në atë kohë, disa lokale, kishën e atëhershme, shkallët e qytetit dhe gjithçka që të kujtonte qytetin. Si mund ta lemë këtë qytet dikur me 20 mijë banorë të zhdukur nga memorja historike ? shtronin pyetjen këta njerëz amerikanë. A do të na e falnin brezat që do të vijjnë që kanë lindur në këtë qytet që nuk do të egzistonte më ? Ata e rindërtuan qytetin nga e para. Po ne ç'duhet të bëjmë ? Ne nuk po ndërtojmë as varrezat e të parëve tanë. Është e pafalshme për komunitetin e Steblevës , një komunitet me biznesmenë, tregëtarë, intelektualë, që të mos kujdeset për historinë e tij. Atë që po bën gazeta lokale "Stebleva" duhet ta shtrijmë deri në detaje konkrete. Çfarë tu tregojmë turistëve të huaj kur nuk kemi as varreza për të qenë ? Ku është respekti për të parët tanë që na e lanë amanet tokën tonë që e fituan me gjak dhe me mund të madh ?

Ju bëj thirrje të dashur bashkëfshatarë të kontribojmë të gjithë dhe të hidhemi në aksion për rindërtimin e varrezave, ashtu siç e rindërtuam në kohë rekord xhaminë e fshatit ashtu të rindërtojmë dhe të mbajmë siç e meritojnë varrezat e të parëve tanë.

Me respekt
Ferit Pirushi

Një jetë në shërbim të fshatit

(Intervistë me Jakup Projkun para vdekjes, më 6 maj 2005)

Nga: ALBERT KITA

Xha Jakup, na fol pak për jetën tënde.

Kam lindur në vitin 1916, pikërisht në kohën e Luftës së I Botërore dhe të pushimit bullgar. Nuk kam në lindur në Steblevë, sepse ishim shpërngullur të gjithë nga sulmi bullgar. Familja ime ishte vendosur në Zdrish të Librazhdit, ku lindi unë. Jemi kthyer pas tre katër vjetësh. Pas kthimit në Steblevë, fill pas dy vjetësh më vdiq babai dhe mbeta jetim. Babai vdiq aksidentalisht duke prerë dhe mbledhë dushk. U detyrova që në moshë të vogël të shkoj në Tiranë për të punuar.



A je i kënaqur apo i mërzitur nga jeta që ke bërë ?

Jam 88 vjeç dhe jam i kënaqur me jetën që kam bërë në krahasim me kohën në të cilën kam jetuar dhe kemi jetuar të gjithë si komb. Sa të jem gjallë dua që të jem me këmbë e me dorë e të mos mërzis njeri. Por më dhemb në shpirt kjo braktisje që po i bëhet fshatit. Është braktisja e katërt. Tre herë e dogjën armiqtë Ste-

blevën dhe u detyruam të largohemi përkohësisht. U rikthyem që të tre herët dhe e rindërtuam Steblevën. Nuk më pëlqen kjo braktisja e tanishme gjoja për një jetë më të mirë. Braktisen shpëtitë, shkolla, puna, klinika mjekësore, sharrat dhe shkohen larg në Tiranë, Elbasan, Durrës apo edhe më larg në dhe të huaj. Kam qenë 20 vjet kryetar i këshillit popullor të fshatit, kryeplak, pa taserë partie,

por me taserën e atdashedurisë. Gjithë jetën time ja kushtova fshatit tim të dashur, Steblevës dhe njerëzve të tij. Unë vij prërsëri çdo 6 maj. Nuk më ndahet shpirti nga ky vend i bekuar me klimë të mrekullueshme dhe me ujë të kristaltë. Sot më 6 maj sikur më është rigjeneruar shpirti. Ndoshta nga ky ujë i bekuar i Vakëfit të Steblevës, nga këngët dhe vallet popullore të bashkëfash-

tarëve të mija, nga kostumet shumëngjyrëshe të tyre.

Cili ka qenë kontributi si kryetar këshilli fshati gjatë 20 vjetëve ?

Më ke kapur ngushtë. Është pyetje pak e vështirë për tu shpjeguar dhe kuptuar nga ju të rinjtë e sotëm. Ju nuk e vini dot vehten në ato vite dhe në ato kushte ku kemi kaluar ne. Të të them se kemi kaluar në vrimë të gjilpërës është pak.

Për të mbrojtur bashkëfshatarët të cilët të kanë votuar (se edhe atëhere votohej), bile kryeplaku absolutisht duhet të miratohej në popull, më është deshur që të punoj fort dhe të sakrifikoja shumë. Askujt nuk ikam hyrë në hak, megjithëse kishte pak bursa studimi, kishte pak radio, televizorë e frigoriferë për të shpërndarë për popullin, kishte pak mish e qumësht, megjithëse ne ishim fshat i begatë. Në vitin 1966 fshati u bë kooperativë bujqësore dhe u hapën disa institucione social kulturore. Vetë i pari ja hoqa duvakun vajzës time dhe në këmbë e nisa në dasmën e saj, duke zhdukur disa zakone prapanike për kohën. Vetë shkova me vajzat e fshatit në aksionin e rinisë për ndërtimin e hekurudhës Lushnjë-Vlorë. Vetë qëndrova në krye të eliminit të pasojave të tërmetit të vitit 1967. Duke punuar me ndershmeri në atë kohë shoh që tani më respektojnë edhe më shumë. Kjo më kënaq së tepërmi. Uroj që frymën e dashurisë për fshatin dhe për njerëzit e tij ta çoni më tej ju djemtë e ri.

ALI PROJKA, NJERIU PA DUAR, QË PUNONTE MË SHUMË SE TË TJERËT

Nga: EMIN PROJKA

Ali Ahmet Projku lindi në Steblevë në vitin 1899. Ai u rrit në një familje të varfër. I detyruar nga kushtet që në moshën 16 vjeç shkon në Durrës dhe punon në molin e tij si punëtor ngarkim shkarkimi. Pas një farë kohe kthehet në Steblevë dhe punon në botore ose në ndërmarrjen e rruga-urave. Përgjegjës i ndërmarrjes në atë kohë ka qenë Hamza Duda nga Shkodra. Me Hamzain krijoi një miqësi të madhe, miqësi që vazhdoi për shumë kohë, edhe pas vdekjes së Hamzait. Punon për një periudhë kohe në Sarandë së bashku me vëlalin e tij Mustafain. Kthehet nga Saranda në Steblevë dhe vazhdon punën në Steblevë. Në vitin 1930 martohet me Aishe Zgorgën, me të cilën pati 10 fëmijë.

Në vitin 1944 aksidentohet nga një bombë luftarake në përpjekje për të shpëtuar disa fëmijë që e kishin gjetur këtë bombë. Bomba i plasi në duar dhe ja këputi



të dyja duart. Mbeti kështu sakat për tërë jetën. Por nuk u gjuhëzua ky njeri nga fati dhe nga fatkeqësia që i ndodhi. Edhe nga halli sepse kishte për të rritur 10 fëmijë të vegjël, edhe nga damari i punës që e karakterizonte ai gjeti mënyra për të punuar. Krijoi proteza llamarine që i vendosi në krahë dhe me to punonte me karrocë, me lo-

patë, kazëm e tj.

Në vitin 1947 fshati e caktoi si korrier dhe e paguante fshatçe për ti ardhur edhe në ndihmë atij. Këtë punë ai e kreu për 20 vjet me rradhë, me besnikëri dhe devocion. I binte rreth e qark fshatit, në male, pyje, kullota, livadhe, ara e tj, në Raduç, në Dragan, në Kallkan, në Visharicë e gjeje atë kudo

dhe kurdo herë në mbrojtje të pronës së fshatit. Njerëzsi e donin dhe e respektonin. E ushqenin, i jepnin cigare, pije dhe çfarë kishin. Ai ishte i lidhur edhe me postën kufitare dhe ndihmonte njerëzit që punonin në brez-in kufitar.

Pas vitit 1966 filloi të punonte direkt në prodhim, në punë are, në hapje

kanalësh, në lërimin e tokës me qe etj. Sajoi një protezë me llamarinë ku fuste duart e gjymtuara, i mbështille me shajak që të mos i vriteshin dhe punonte. Ai ka qenë edhe në aksione kombëtare si në hekurudhën Rrogzhi në Fier në vitin 1968, në hekurudhën Elbasan Përrenjas në vitin 1969 etj. Në këto aksione është shquar për punë të madhe duke u bërë shembull frymëzimi për të rinjtë e kohës. Në aksionin e rinisë në hekurudhën Rrogzhi në Fier vjen një gazetar dhe mer vesh që këtu punonte edhe një njeri i gjymtuar. U habit dhe vendosi që ta shikonte dhe të bisedonte me të. Pasi pa veglat e punës që kishte krijuar Aliu, e ndoqi atë në punë, shkroi një shkrim për gazetën e atëhershme "Zëri i Popullit".

Aliu vdiq në punë në vitin 1977, në moshën 78 vjeçare. Ai ishte një shembull vetmohimi dhe sacrifice për të gjitha bashkëfshatarët e tij dhe për të gjithë ata që punuan dhe e njohën atë.

BIJTË KTHEHEN NË VENDLINDJE

Nga festimi i 6 majit në Steblevë

(Televizioni Top Channel
filmon festën)

Dita e shumëpritur e Shëngjergjit erdhi. Makinat me targa TR, DR, DI, BZ, EL, LB etj ecin drejt Steblevës, këtij fshati që ka patur 300 shtëpi dhe që tani këto 300 shtëpi janë shumë por jo në Steblevë, por në të gjithë Shqipërinë, jo vetëm në Tiranë, Durrës, Elbasan, Librazhd, Dibër e Bulqizë por edhe në Shkup, Selanik e Stamboll bile edhe në Nju Jork. Makina të shumta, vetura fuori strada e fugonë vinë me datën 5 maj dhe vazhdojnë edhe të tjera në mëngjezin e datës 6 maj.

Përse në Steblevë festohet më shumë se kudo tjetër festa e Shëngjergjit? Kjo festë pagane ka një kuptim të veçantë për steblevasit. Ata nuk arrijnë ta festojnë 14 marsin, ditën e

qyr që kaluan shëndoshë e mirë dimrin dhe dolëm në verë. Festohet më 6 maj të çdo viti. Kjo festë festohet në mënyrë të veçantë nga fëmijët. Në Steblevë kjo festë ka një kuptim të veçantë, sepse dimri në Steblevë dhe në mbarë Gollobordën zgjat shumë. Dita e verës më 14 mars, zakonisht e gjen vendin të mbuluar me dëborë. Kështu që pranvera e vërtetë për steblevasit vjen në muajin maj.

Që para një jave fëmijët e çdo shtëpie ngrihen herët me "rrëmbyer" ujin, do me thënë me mbush ujë dhe me mbledhun degë thanash. Porsi thana e kuqe edhe fëmijët do të rrinin të kuq, të shëndetshëm gjatë gjithë vitit. Të gjitha këto veprime bëheshin pa folur me njëri tjetrin e pa bërë zhurmë pasi sipas plakave mund të mbusheshim me pleshta. Mbase ktheheshim me ujë e rrëm-

ditë ne organizonim lojëra nga më të bukurat si kala dibrançe, lojëra me top, imitim dasdash etj.

Ushqimi i ditës së Shën Gjergjit ishte më i miri i vitit, bukë gruri, vezë të ziera e të lyera me të kuqe, djathë baxhoje, mish pastërma, fiq, gësh-tenja, arra, mollë, etj.

Pasi mblidhim lulet shkonim në shtëpi dhe thirrnim: "O e zonja e shtëpisë, a je këtu? E ajo përgjigjej: "Këtu jam e pleshta s'kam". Lulet i vendosnim nëpër dyert e shtëpive. Zakonisht çonim lule edhe në ato shtëpi që nuk kishin fëmijë të vegjël dhe zonjat e tyre të shtëpisë të gëzuara na uronin e na jepnin vezë të tjera të ziera e na qerasnin me ç'të kishin.

Lojërat e kësaj dite nuk mbaronin deri në të ngrysur.

Me datën 6 maj gatuajmë për të tërë shtëpinë, zakonisht një tepsi me jufka (petas të bëra vetë) me vezë dhe një pelte me niseshte e sheqer. Përgatiteshin ëmbëlsira si gurabija etj.

Kurbani i mishit të qëngjit zë vendin kryesor. Gati çdo shtëpi ther një qëngj. Ata që s'kanë dhe që janë pakicë bashkohen 3-4 familje dhe ndajnë një qëngj, por e rëndësishme është që mishi i qingjit, zakonisht i pjekur në qumësht të jetë menyja kryesore e kësaj dite të shënuar. Burrat nxjerrin rakinë më të mirë që kanë, disa edhe verë. Tani kanë hyrë edhe pijet e tjera si birra, coca-cola etj.

Gratë dhe vajzat vishen me kostumet popullore të zonës. Një festival i vërtetë dhe një ditë e paharruar që nuk harrohet lehtë.

TË PISH PAK UJË TË BEKUAR TEK VAKËFI I STEBLEVËS

Kemi folur për bukuritë e Steblevës por nuk kemi folur për Vakëfin e Steblevës dhe ujin e bekuar të tij. Në anë të rrugës automobilistike kombëtare, në të dalë të postës kufitare të Steblevës është ky vend i bekuar që nuk e prek njeri vetëm e mirëmban dhe e respekton. Këto livadhe të blerta janë bërë për të pushuar njerëzit, ky burim nga goja e pyjeve është bërë për të pirë barinjët dhe rrugëtarët në nevojë, këto ahe shekullore janë bërë për të

byer i spërkatnim prindërit me pika uji të cilët zgjoheshin të gëzuar dhe na uronin e përkëdhelnin me fjalë nga më të gëzueshmet.

Ky rit një javor bëhej që në fëmijët të mësoheshim të ngriheshim herët, të duronim ujët e ftohët e të rriteshim të shëndetshëm.

Të gjithë fëmijët prej 15 vjeç e poshtë shkonim të mblidhim lule nëpër lëndina. Me ne bashkoheshin edhe më të rriturit vajza e djem deri në 18 vjeç që për çudi në këtë ditë e kishin lejen e prindërve pasi në këtë



lëshuar hije për të pushuar njerëzit. Afrohemi tek burimi që tashmë është kthyer në një cezëm të re e të bukur, pimë ujë, lajmë faqet dhe mendojmë dëshirat e jetës. Vijnë të gjithë moshat, pleqtë, të rinjtë, gratë dhe vajzat, fëmijët, vijnë dhe marrin nga bekimi i tij.

Edhe të ftuarit pasi bëjnë ritet e fshatit hedhin valle bashkë me banorët e Steblevës. Kryetari i Shoqatës "Stebleva" Mersin Hoxha u uron mirëseardhjen.

KËNGË, VALLE, HARE

Ka ardhur orkestra më e mirë nga Elbasani e drejtuar nga një bir Stebleve, e cila me gjeneratorë e bokse të mëdhenj përhap tinguj këngësh dasme. Dasmë e vërtetë. Të shumtë

janë ata që kanë therur kurbanë, qingja e keca të njomë, që i pjekin në hell dhe i "shuajnë" me raki të fortë të bërë vetë ose BMV sic i thonë vendasit që i besojnë dhe e shijojnë prodhimin e tyre "bio". Por nuk mungojnë as birra, vera, uiski dhe red bull. Tregëtarët janë kujdesur që të mos mungojë asgjë.

Bisnesmenët vendas që kanë bizneset e tyre në Tiranë dhe vende të tjera kanë plane perspektive për të bërë falas edhe një mulli bloje për fshatin. Edhe një teleferik ndoshta së shpejti do të shërbejë për alpinizmin dhe turizmin lokal dhe kombëtar. Janë ndërtuar katër kabinat e para për turistët verorë.

A. Tamizi



verës sepse këtu dimri i madh dhe dëborat largohen vetëm në fund të prillit dhe fillim të majit. Edhe lulet e verës i mbledhin më 5 maj. Gjallëri dhe drita kanë të gjitha shtëpitë e Steblevës që nga data 5 maj që janë populluar në mënyrë të tejskajshme, me miq e dashamirës të shumtë.

FESTIMI I SHËN GJERGJIT

Dita e Shën Gjergjit është festë pagane. Atë e festojnë të gjithë, katolikë, ortodoksë dhe myslimanë së bashku, për shy-



"Dy martiret e Steblevës", një libër me vlera atdhetare dhe një thirrje për kujtesë kombëtare..

(Shënime për librin e ri të autorit Kujtim Boriçi)

"Dy heroinat nënë e bijë, Xhemile e Rabije Abazi, vranë mizorisht nga çetnikët serbë, vijnë në këtë libër nëpërmjet dokumentave arkivore e dëshmime të kohës si personifikim i grave gollobordase, i nënave dhe vajzave të Steblevës, që për nderin e lirinë e kombit luftuan e ranë me armë në dorë përkrah burrave në front,"

Përfundova së lexuari librin "Dy martiret e Steblevës", me autor zotin Kujtim Boriçi. Libri përmes një retrospektive dhe dokumentave arkivore evidenton aktin heroik të dy grave steblevase, nënë e bijë, Xhemile e Rabije Abazi gjatë rezistencës që i bënë steblevasit inkursionit të ushtrive serbe për të dalë në Durrës, tetor 1913. Këto inkursione nuk rreshtën përgjatë viteve 1912-1920 në tërë Dibrën e në veçanti në Gollobordë, ku Stebleva u dogj tri herë në vitet: 1913-1915-1920. Akti i këtyre dy martireve do të pasohej me aktin e dhjetra grave të tjera në betejat me serbët. Nëna Neslie Shabani, kur shikon të birin, Adem Shabanin të vranë, me sopatën në dorë, pasi vret dy serbë martirizohet pranë të birin.

Pas dhjetra grave ecte Neslie Ereqi nga Gjinoveci, e shoqja e Kasem Buziut në Klenjë, për në Sebisht, por atje në majë të malit e arrijnë serbët dhe e vrasin me fëmijën në bark. Sot e kësaj dite maja e malit quhet Buzica.

Teksa vazhdon të lexosh këtë libër, mendja të shkon tek tre gratë e Trebishtit me në krye Hysnie Seferin, e ëma e Adem Seferit nga Dibra e Madhe, të cilët i dolën Komisionit Ndërkombëtar për caktimin e kufijve ngarkuar me dru në vendin e quajtur Guri i Vogël, (Mallkamen). Kur i pyetën: "Gde je put za Opshtina?", (ku është rruga për në komunë?), ata iu përgjigjën shqip: "Shkoni përpara, atje në qendër."


Po kështu qëndrimi heroik i nënë Hajries në Ostren të Madh, kur i sollën të torturuar djalin e saj, Hamdi Muçën, mësuesin patriot. Apo qëndrimi i nënë Medihisë, kur mori vesh vrasjen e djalit të saj, Elez Koci.

Në betejën e Qafës së Prevallit, mes 500 të masakruarve ishin me dhjetra gra me fëmijë në duar nga fshatrat e Gollobordës e në veçanti u martirizuan komplet familjet e Shaban Lloshit, Hasan Kalecit, Agim Gjinit, Liman Gjinit, Hamza Stafës, Arif Xhafës, Mersim Halilit nga Zabzuni.

Në djegien e tretë të Steblevës, kur serbët me mercenarët e Xhem Kosturit e të Daut Hodës kërkonin nusët për në Serbi:

"Nevesto oko kalesho
Da stanish utre po rano
Da spremash konja doria,
Utre qe odish vo Serbia.

Nuse moj syzezë
Të çohesh herët në mëngjes,
Të bësh gati kalin,
Nesër do të shkosh në Serbi."



Krahas burrave spikati heroizmi i grave si: Hatixhe Kormaku, Sulltane Hoxha, Fatime Hoxha, Mejte Disha, Selime Bojaxhiu, Zylfie Murati.

Betejën e Steblevës populli e ka perjetësuar në këto vargje:

Xhemal Begu u ngrit në këmbë

Daut Hodën ku e kam:
-Urdhëro Beg se këtu jam.
-Mblidhi shokët me ndigjue,
Një ferman kemi me këndue;
"Krajli i serbit na ka çue,

Në Steblevë për me shkue,
Tanë katundin me rrethue,
Një kambë burri mos me shpëtue
Me qenë zog me fluturue."
E rrethoi, e qarkoi,
Asnjë burrë nuk i kaloi.
Plasi pushka në Killavec,
Gjithë Stebleva u ngrit në kambë,

Plasi pushka flakë për flakë,
Shokët e Xhemës u bënë me gjak.
Po shkon gjaku tuj kullue,
Daut Hoda ka mbarue.

Promovohet libri "Dy martiret e Steblevës" i publicistit Kujtim Boriçi

Ditën e shtunë me datë 22 maj 2010 në sallën e Shtëpisë së Ushtarakëve të Forcave të Armatosura, në Tiranë u bë promovimi i monografisë "Dy martiret e Steblevës" kushtuar dy martireve nënë e bijë nga Stebleva, Xhemile dhe Rabije Abazi, vranë nga pushtuesit serbë në vitin 1920.

Pushtimet serbo-sllave të Steblevës, Zabzunit, Borovës e fshatrave të tjerë të Gollobordës, ndonëse nga më mizoret ndër invazionet e ushtrive të huaja ndaj vendit tonë, fatkeqësisht janë lënë për një kohë të gjatë nën pluhurin e harresës. Për to është folur fare pak, shumë vonë e në mënyrë sporadike, ndonëse i përkasim një kohe jo më të largët se një shekull... Pikërisht për këtë pjesë të historisë, të shtunën në Shtëpinë Qendrore të Ushtrisë në Tiranë u promovua libri "Dy martiret e Steblevës", i

autorit Kujtim Boriçi.

Pas prezantimit të librit nga studiuesi Ramazan Hoxha, në promovim për vlerat e botimit folën studiuesi Neritan Ceka, Xhevit Boriçi i komunës së Steblevës, poeti Agim Doçi, krijuesi Ilir Ballili, shkrimtari Mevlut Buci e më tej studiuesi dhe krijuesi Vasil Premçi, shkrimtari Hasan Shahinaj, studiuesi Eduart Abazi etj. Pjesëmarrësit e cilësuan mëkat luftën e bërë në ato vite. Sipas historianit Pëllumb Gjini, ky mëkat ka ndodhur ndoshta nga këndvështrimet e deformatuara të historisë prej politikave të kohës, por edhe për "faj" të historianëve, të cilët për shkak të ndryshme i kanë anashkaluar ngjarjet, fenomenet dhe njerëzit e kësaj zone. Me heroizëm e gjak, i madh e i vogël, burra e gra së bashku nëshkruan epikën e qëndresës heroike për mbrojtjen e vendit dhe nderit të tyre.

Libri i Kujtim Boriçit, "Dy

Daut Hoda qoft mallkue,
Ku i le shokët në atë përrue?
Ca të vranë, ca të plague.
Gajret burra me qëndrue,
Vjen Borova me sulmue,
Vjen Zabzuni me ju ndihmue.
Plasi pushka te stanet
e Bales,
Posi lufta e Çanakales,
Plasi pushka, gjëmonte toka,
Kujtoi Xhema se erdh Evropa.

Mizoritë serbe në fillim të shek.XX në Gollobordë, Steblevë e në Dibër janë rrenqethëse e nuk mund të shlyhen lehtë nga kujtesa popullore. Ato kanë vazhduar me mjete të tjera dhune, presioni e asimilimi gjatë gjithë shek. XX në trojet shqiptare në Maqedoni, Kosovë e Mal të Zi, pra në ish Jugosllavi. U rishfaqën egërsisht në prag të mijëvjeçarit të ri, me genocidin ndaj Kosovës në vitin 1999. Dëbimet masive, djegjet, vrasjet, përdhunimet nxorrën edhe njëherë egërsinë në gen të çetnikëve serbë. Masakra e Reçakut, vrasja e Heroit legjendar Adem Jasharit me 50 pjestarë të familjes në Prekaz përbëjnë kulmin e kësaj histerie antinjerëzore e anti shqiptare.

"Plaget hapen, kur ftohen," shprehet intelektualja e shquar kosovare, Flora Brovina.

Ja çfarë shkruan në librin e saj "Rrëfimet e femrave të dhunuara gjatë luftës në Kosovë", autorja kosovare Luljeta Selimi:

"Ma pushkatuan nënën e vëllanë, kurse mua më dhunuan dhe trupin ma masakruan për së gjalli me cigare. Fëmijët vajtonin mbi trupin e përgjakur të babait të tyre të vranë, kurse mua me çnderonin vetëm disa metra larg tij. Pasi me vranë djalin, mua më çnderonin për disa ditë me radhë. Më dhunuan para syve të

nënës. Më dhunuan dhe ma prenë gjirin. Cigaren e ndezur e fiknin mbi gjijtë e mi. Më detyronin të shikoja femrat që po i dhunonin me radhë. Pasi më dhunuan më hoqën thonjtë me dana. Pasi e dhunuan 13 vjeçaren, e hodhën në pus. Më çnderuan para syve të babait e të nënës. Në muajin e tetë të shtatëzanisë më dhunuan para vjehrrës dhe burrit e pastaj më goditën në gjoks e në bark dhe linda fëmijën e vdekur. Më dhunuan e në krah më vizatuan kryqin serb..."

(1. Gazeta "Rruga e Arbërit" fq. 13. Dhjetor 2008.)

"Dy heroinat nënë e bijë, Xhemile e Rabije Abazi, vranë mizorisht nga çetnikët serbë, vijnë në këtë libër nëpërmjet dokumentave arkivore e dëshmime të kohës si personifikim i grave gollobordase, i nënave dhe vajzave të Steblevës, që për nderin e lirinë e kombit luftuan e ranë me armë në dorë përkrah burrave në front," thekson mes të tjerave redaktori i librit Eduart Abazi.

Për sa më sipër libri "Martiret e Steblevës" merr vlera duke rizgjuar kujtesën popullore për të mos haruar edhe pse sot nga gjithë popujt e Ballkanit nga politikanë e intelektualë po hidhen ura miqësie e bashkëpunimi për një Ballkan pa lufta, në paqe e në harmoni me kultura integruese në Europën e Bashkuar.

Falenderime i takojnë autorit Kujtim Boriçi.

Libri "Martiret e Steblevës" për mesazhet që përcjell në breza do të hyje në fondin e librave me vlerë në trevën e Gollobordës, të Dibrës e më gjërë.

Mehmet Hasani.
Zv.kryetar i Unionit të Krijuesve Dibranë

dashur e pasurinë (u dogjën tri herë), kurrë nuk i lanë sakrificat dhe përpjekjet të mbrojtjes të lirisë. Dëshmoreve të Atdheut, Xhemile e Rabije Abazi, nënë e bijë, autori u plotëson një detyrim intelektual për të ndriçuar sadopak një ngjarje, protagonistët e së cilës ndonëse mbrojtën me gjakun e tyre vatanin, fatkeqësisht mbetën në harresë për dekada të tëra. Duke gërmuar arkivat, dëshmitë e bashkëkohësve dhe ato të transmetuara brezave për dy martiret, duke sjellë ngjarje e emra të luftëtarëve të Steblevës e fshatrave të tjerë në faqet e librit, ai prezanton një kontribut me vlerë në pasurimin e historisë së kësaj treve me tradita të shumta, por siç e përmendëm dhe më lart, fatkeqësisht, të lëna pas dore për një kohë të gjatë.

Ferit Fixha

Homazh për të gjitha gratë e vajzat luftëtare shqiptare, dibrane dhe të Steblevës

"Dy martiret e Steblevës" është libri i dhjetë me poezi, prozë dhe shënime historike i poetit dhe gazetarit Kujtim Boriçi. Pas librit "Ata erdhën nga Stebleva", autori Boriçi përsëri i rikthehet me sukses temës së historisë në zonën e Steblevës dhe të Gollobordës. Ky libër jep një kontribut të madh për njohjen dhe evidencimin e qëndresës heroike të kësaj zonë me tradita atdhetare. Libri u kushtohet trimëreshave Rabiye dhe Xhemile Abazi, të cilat u vranë barbarisht nga pushtuesit serbë.

Historia e Steblevës dhe Gollobordës në tërësi është një histori akoma e pathënë dhe e pashkruar plotësisht. Historia dhe kultura e kësaj zone nis me pellazgët dhe me ilirët dhe vazhdon deri në ditët tona. Popullit shqiptar në tërësi dhe Dibrës, Gollobordës dhe Steblevës në veçanti u është dashur të derdhin shumë gjak,

Historia e Steblevës dhe Gollobordës në tërësi është një histori akoma e pathënë dhe e pashkruar plotësisht. Historia dhe kultura e kësaj zone nis me pellazgët dhe me ilirët dhe vazhdon deri në ditët tona. Popullit shqiptar në tërësi dhe Dibrës, Gollobordës dhe Steblevës në veçanti u është dashur të derdhin shumë gjak, të bëjnë shumë sakrificë për lirinë dhe pavarësinë e tyre.

të bëjnë shumë sakrificë për lirinë dhe pavarësinë e tyre.

Ne steblevasit nuk mburremi, nuk dimë të mburremi, por përkundrazi jemi shumë modestë, nuk reklamojmë as vlerat e historisë sonë. Kështu ka ngjarë deri më sot me historinë e këtyre dy martireve. Nga Stebleva, por me nënën nga Sebishti është udhëheqësi i Turqisë modern Mustafa Qemal Atatürk, pavarësisht se ka lindur në Selanik, dhe

Koxhaxhiku si kala më e madhe pretendon të marrë autorësinë. Nga Stebleva është Hazis Lila, delegat i Kongresit të Manastirit për Steblevën dhe Berzeshtën. Nga Zabzuni është Heroi i Popullit Qemal Stafa, pavarësisht se për 50 vjet me rradhë të regjimit monist u tha se është nga Elbasani, kur në Elbasan ishte shpëngulur nga Zabzuni. Dhe kështu mund të vazhdojmë me shembuj të tjerë lavdie dhe heroizmi.

Edhe për këto dy martire, librin kushtuar të cilave promovojmë sot, ka patur vetëm një vendim për tu shpallur dëshmore të Atdheut dhe më pas

heshtje. Me dokumente arkivore dhe fakte tregohet se si u vranë dhe u përçudnuan këto dy gratë të Steblevës nga çetnikët serbë. Këto dy luftëtare u vranë përkrah burrave të tyre në luftime për mbrojtjen e trojeve tona, të cilat serbët pas vitit 1913 kërkonin ti zaptonin me luftë, por hasën në qëndresën e kësaj zone heroike.

Për shumë arsye, e bukura Gollobordë, ndër më të bukurat e dheut Shqiptar, është parë më syze të turbullta. Veçanërisht periudha e luftimeve kundër pushtimeve serbo-bullgare, të viteve 1913-1920, e Steblevës, Borovës, Zabzunit, Qafë Përvallit, etj është lënë në heshtje dhe në errësirë qëllimisht. I pari që shkruajti dhe nxorri nga arkivat luftën patriotike të kësaj zone ishte mësuesi veteran Islam Hoxha. Me dorën e tij janë bërë dëshmorë dhe veteran shumë njerëz në zonën tonë.

Ky libër është një homazh për të gjitha gratë e vajzat luftëtare shqiptare, dibrane, të Gollobordës dhe të Steblevës. Një nga këto ka qenë edhe

Neslie Shabani, të cilën e therën me bajonetë së bashku me të birin Ademin, tek po gatuente në magje bukë për luftëtarët e frontit antiserb, është homazh për Ibrahim Koduzen, Ibrahim Tetjen, Hysen Lloshën etj të cilët u masakruan me bajonetë nga ushtarët serbë. Është folur pak deri më tani, dhe ka shumë për të folur dhe shkruar, por ky libër është një fillim i mirë, që të gjithë të shkruajnë dhe të kontribuojnë për historinë tonë. Sa e sa nënave ju fut bajoneta në bark në vitet 1913-1920, që të mos i lindnin fëmijët e tyre, dhe ky popull të shuhej, por kjo nuk ndodhi dhe nuk do të ndodhë kurrë. Të gjithë ne jemi të obliguar të vazhdojmë vallen heroike dhe hyjnore të paraardhësve tanë, vallen e Selman Gaxhës, Hysen Lilës, Islam Lamës, Medin Kormakut, Neslie Shabanit, Xhemile e Rabiye Abazit dhe të shumë e shumë heronjve e heroinave të Steblevës. Shembulli i këtij libri tregon se jemi në rrugën e duhur.

Ramazan Hoxha,
studues

Rruga Librazhd-Steblevë, shpresa e madhe e banorëve të zonës

(Punimet janë ndërprerë, për shkak të vonësive në lëvrimin e fondit)

(Marrë nga gazeta "Shqip" e datës 7 qershor 2010)

Rilindja e kësaj zonë të largët lidhet me ndërtimin e aksit të rrugës nacionale, përkatësisht segmentit prej mbi 35 km Librazhd-Steblevë. Para disa vitesh u vendos të bëhet rikonstruksioni i rrugës, por ndonëse kanë kaluar mjaft kohë, punimet nuk kanë përfunduar. Dy vjet më parë falë një finacimi prej 470 milion lekësh të akorduara nga buxheti i shtetit, përfundoi një pjesë rruge. U shtruan rreth 2 km rrugë nga Librazhdi në Togëz. Ndërkohë që punimet për pjesën tjetër të segmentit kanë një vit që kanë nisur dhe janë ndaluar. Shkak janë bërë vonesat në lëvrimin e parave nga shteti për firmat sipërmarrëse të kontraktuara nëpërmjet tenderimit. Të mbeturit në këtë zonë jetojnë me shpresën e ndërtimit të rrugës. Ata shpresojnë që infrastruktura do të sjellë zhvillim e të ardhura më të mëdha për ta dhe për zonën, ndërkohë që shpresojnë që në këtë mënyrë do të ribashkohen me pjesën tjetër të të afërmëve që kanë ikur dhe janë gati të kthehen sërish.

-Unë nuk luaj nga ky vend, por shoh se kushurinjtë tanë kanë nisur prej vitesh që të investojnë në zonë, qoftë për rindërtimin eshtëpive të lënë bosh, qoftë edhe në fushën e turizmit, me shpresën se një ditë do të kthehen, thotë Rexhep Kurti, kryeplak i fshatit Steblevë.

Besim Dybeli



ISLAM FERIT ÇAUSHI, DËSHMOR I LUFTËS NACIONAL ÇLIRIMTARE (1922-1945)

Shkolla e 9 vjeçare dhe ajo e mesme e bashkuar e Steblevës ka mbajtur ndër vite emrin e birit të Steblevës, Islam Ferit Çausi.

Islam Çausi u lind në vitin 1922 në Luz të Kavajës. Familja e tij si dhe shumë familje të tjera nga Stebleva u shpëngulën përkohësisht për ti shpëtuar terrorit serb në vitin 1915. Mbas djegjes së fshatit dhe të shtëpisë së tyre nga serbët ata morën rrugën si muhaxhirë dhe zunë vend në Luz të Kavajës. Kthehen në Steblevë në vitin 1928 dhe ndërtojnë një shtëpi të re. Këtu në fshat Islami bëri mësimet



e para më mësues Vahid Kormakun, ku kreu katër klasë fil-

lore. Më pas punoi për pak kohë në restorantin e Çausajve në Elbasan. Pas pushtimit fashist dhe nazist ai u përfshi në rradhët e Luftës nacionalçlirimtare në Brigadën e I Sulmuese ku dha edhe jetën pikërisht pas çlirimt të vendit, kur Shqipëria ishte çliruar dhe Brigada po luftonte në malësinë Shkodrës përtej kufijve shtetërorë në janar 1945. Islam Çausi mban titullin "Dëshmor i Atdheut". Varri i tij është pranë varrezave të dëshmorëve të Dibrës në Peshkopi.

Përgatiti:
Rruzdi Kormaku

Falenderim për Televizionin Kombëtar "Top Channel"

Një grup xhirimi i televizionit TCH. me ftesë të shoqatës "Stebleva" filloi festimin e 6 majit në Steblevë. Grupi nuk xhiro vetëm festën e organizuar, por edhe natyrën e bukur të këtij fshati piktoresk. Kamera e TCH intervistoi fshatarët që banojnë në këtë fshat si dhe kryetarin e Shoqatës "Stebleva" i cili afishoi punën e bërë deri më tani dhe planet për të ardhmen, për ta rigjeneruar nga e para këtë fshat të bukur, perlë të natyrës shqiptare.

Ky telereportazh disa minutësh u transmetua në emision "Pasdite në TCH. Gazetarja Alma Sula dhe kryeredaktori i emisionit Sokol Shameti kishin bërë një punë të mirë dhe të kujdesëshme për seleksionimin e materialeve dhe për të dhënë vlerat e këtij fshati turistik, që mbart edhe vlera të lashta historike.

Ju faleminderit gazetarë dhe kameramanë të TCH, të këtij televizioni kombëtar që e ndjek popullin e tij në çdo vend dhe në çdo çast.

KRYESIA E SHOQATËS "STEBLEVA"

Nderim për ish presidentin amerikan Bill Clinton

Ai pritet si hero në Prishtinë

Një statujë e madhe përurohet në mes të Prishtinës për nder të tij

Pas zbulimit të shtatorës, Bill Clinton edhe njëherë ka falënderuar udhëheqësit e vendit dhe popullin e Kosovës, duke thënë se ai ndihet i privilegjuar që atij i është ndërtuar një shtatore sa ishte gjallë. Ai po ashtu ka përsëritur se ka biseduar me gruan e tij, sekretaren e shtetit të SHBA-ve, Hillary Clinton, e cila i ka thënë atij se ai duhet ta bëjë një foto para statujës së tij. "Duhet ta bëni një foto para saj' më tha ajo", tha Clinton. Unë dua të ju them juve disa gjëra në mënyrë serioze, së pari unë jam shumë i nderuar që isha këtu për të ndalur ato gjëra të tmerrshme që u ndodhën juve dhe për të qenë pjesë e asaj që ndodhte këtu. Unë jam shumë i vetëdijshëm se ka pasur edhe shumë të tjerë që kanë ndihmuar për shpëtimin e shumë jetëve në Kosovë dhe që iu kanë ndihmuar juve për të ndërtuar demokracinë", tha Clinton.

Për më tepër, Clinton ka siguruar popullin e Kosovës se do të kenë përherë mbështetjen e palëkundur të Shteteve të Bashkuara të Amerikës. "Para dhjetë vjetëve në kemi ndalur diçka të tmerrshme këtu, ndërsa sot pas dhjetë vjetëve ju jeni duke bërë një punë të mirë, jeni të lirë, jeni të pavarur dhe do të ecni përpara si vend shumëtnik.

Clinton ka rikujtuar edhe ata të cilët pas luftës së Kosovës kontribuan në ndërtimin e shtetit të Kosovës. Ai ka falënderuar NATO-n, ish-sekretaren e shtetit Madeleine Albright, Uesley Clark, ish-presidentin George Bush dhe ish-sekretaren Condolize Rice për kontributin e dhënë. "Dhe dua t'ju siguroj se edhe administrata e tanishme në krye me presidentin Obama dhe sekretaren Hillary Clinton do ju ndihmojnë për të ndërtuar të ardhmen", tha ai.

Ndërsa kryeministri Thaçi ka premtuar se sheshin Bill Clinton do ta bëjë një shesh madhështor për Kosovën. "Shtatorja e juaj është shtatore që i përket të gjithë qytetarëve të Kosovës sepse ju jeni hero i popullit të vendit tim", tha Thaçi.

Kryetari i Shoqatës, "Miqte e Amerikës", Agim Rexhepi ka thënë se kjo shtatore, në sheshin që mban emrin e tij është nderimi që populli i Kosovës ia bën një heroi në të gjallë të tij. Skulptura është punuar nga skulptori Hezair Mustafa, ndërkaq në pritje të Clinton kanë dalë

me mijëra njerëz për ta nderuar mikun e tyre!

Clinton: Kosova ka ndërtuar institucione demokratike

Ish-presidenti i SHBA Bill Clinton në fjalimin që ka mbajtur para deputeteve të Kuvendit të Kosovës ka thënë se Kosova me punën e saj ka arritur që të krijoj institucione demokratike, shtyp të lirë dhe shoqëri të fortë civile. Ai në fjalimin e tij, në fillim, ka përkujtuar edhe ish presidentin e Kosovës, Ibrahim Rugovë dhe një gur të cilin ai ia kishte dhuruar. "Ai gur kristal të cilin ma dha Rugovë i është dhuruar një universiteti por për një kohë ai ishte i njohur edhe në SHBA me emrin

pkukur që të arrihet paqe në Lindje të Mesme. Zëvendës-presidenti Biden por edhe të tjerët kanë treguar përkushtimin e tyre që të ju ndihmojnë", ka thënë Clinton.

Clinton ka treguar se në botë sot nuk ka rëndësi sesa të mëdhenj janë popujt. Sipas tij të gjithë popujt kanë tregimet e veta - të mira dhe të këqija. Ish-presidenti ka thënë se ai do të bëjë gjithçka që është e mundur që t'i ndihmojë përsëri popullit të Kosovës por edhe Kosova nuk duhet të bëjë dallime në mes të fqinjëve të saj. Ndërkaq, ai ka thënë se është krenar me Kosovën. Sipas tij, Kosova ka përparuar, ajo është pranuar



"Guri i Rugovës", ka thënë Clinton. Clinton, ka shtuar se ai është lindur në një vend që ka gjeologji të ngjashme me Kosovën, në Arkanzas. "Atëherë, ai (Rugovë), më tha se duhet të na ndihmosh", ka thënë Clinton.

Clinton po ashtu ka treguar edhe vlerësimet dhe punën që është duke e bërë administrata e tanishme amerikane që Kosova të ecë përpara. "Kur u nisa për në Kosovë bisedova në telefon me Hillary'in dhe edhe ajo u dërgoi të fala nga ana e saj - përderisa është duke u për-

në FMN ndërkaq me hapa të sigurtë është duke shkuar drejt anëtarësimit të saj në NATO dhe BE. Ai ka thënë se "Kosova duhet të jetë Zot i paqes së vet".

Nga ana tjetër Kryetari i Kuvendit të Kosovës, Jakup Krasniqi ka thënë në fillim se ishte pikërisht SHBA dhe miqtë e saj që ndërprejnë një spastrim etnik dhe një katastrofë në Kosovë. "Kosova ka ndryshuar shumë dhe nuk i ngjan më Kosovës së luftës më parë dhe është shndërruar në një vend multietnik pa dallime politike dhe fetare".



Kurse Presidenti i Kosovës, Fatmir Sejdiu tha se populli amerikan ka një meritë të veçantë për pavarësinë e Kosovës. "Qytetarët e Kosovës të janë mirënjohës për vendimin dhe ndërhyrjen ushtarake dhe parandalimin e një gjenocidi të të paparë në Kosovë. Ju nuk lejuat që të flijohen mijëra viktima civile...", tha Sejdiu.

Ndërkaq, kryeministri Thaçi tha se vizita e presidentit Clinton në Kosovë është një ditë e lumtur për të gjithë në shtetin e Kosovës, sepse kështu Kosova nderon mikun më të madh të Kosovës, ish presidentin e SHBA-ve, z. Bill Clinton..

"Ftesa e sotme është një simbol i dashurisë. Festa e sotme është një mirënjohje e thellë nga institucionet e reja të Republikës së Kosovës. Shtatorja që do ta zbulojmë sot është një shtatore për triumfin e paqes dhe të tolerancës në botë. Ju z. Clinton e bashkuat botën demokratike për të ndërhyrë dhe sjell paqe në Kosovë.

Paqen, jetën e lirë, lirinë dhe lumturinë e Kosovës. Zoti i bekoftë SHBA, Kosovën, juve z. President, familjen tuaj", tha Thaçi. Republika e Kosovës do t'u jetë përherë mirënjohëse Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe Presidentit Clinton, i cili, në çastet në të rënda të historisë sonë, udhëhoqi aleancën e madhe të vendeve demokratike e liridashëse të botës për ta ndaluar makinerinë gjenocidiale të Millosheviçit, e cila po e dëbonte popullin e Kosovës nga vatrën e veta, si dhe po i shndërronte fshatrat e qytetet tona në tokë të djegur", ka thënë Sejdiu. Po ashtu, Presidenti Sejdiu ka theksuar se vizita e Presidentit Clinton në Kosovë, e para pas pavarësimit të vendit, është një inkurajim i madh për institucionet dhe qytetarët e Republikës së Kosovës, në udhën e pakthyeshme të integritetit euroatlantike.

**Përgatiti për botim :
Vath Gruda**

